



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, Datë 22.07.2015

P Ë R

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES NË LEJEN  
ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR “NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT TURISTIK  
“HOTEL PALACE”, MIRATUAR ME VENDIM NR. 5 DATË 07.03.2014 TË KKT,  
ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 59 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit.

V E N D O S I:

1. Miratohet kërkesa e shoqërisë “Amadeus Palace” sh.a, për ndryshimin e emrit të zhvilluesit në *Lejen Zhvillimore Komplekse për “Ndërtimin e kompleksit turistik “Hotel Palace”, miratuar me vendim nr.5, datë 07.03.2014 të KKT*, e cila nga shoqëria zhvilluese “Amadeus Group” sh.a, bëhet shoqëria zhvilluese “Amadeus Palace” sh.a.
2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË, DHE SIPËRMARRJES**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**